

ERASMUS + Mobiliteti i Stafit Akademik në “University of Natural Resources and Life Sciences”, Vienna (BOKU) në Austri 18-24 Qershor 2023

Në kuadër të marrëveshjes ndër-institucionale 2022-2024 Erasmus + ndërmjet Universitetit BOKU “The University of Natural Resources and Life Sciences” dhe Universitetit të Prishtinës – Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, është duke u zhvilluar mobiliteti i stafit akademik i FIN-it, Departamentit të Hidroteknikës përbërë nga: Prof. Ass. Dr. Lavdim Osmanaj, MSc. Premton Thaqi asistent, dhe MSc. Hana Shehu Agani asistente. Ky mobilitet do të zhvillohet gjatë datave 18-24 Qershor 2023.

Qëllimi i shkëmbimit të stafit akademik të FIN-in është thellimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimi i eksperiencave ndërmjet dy Institucioneve si dhe mundësia e vazhimit të studimeve në nivelin PhD për stafin akademik.

Gjatë takimeve të planifikuara gjatë javës do të prezentohet Universiteti i Prishtinës, Universiteti Nderkombëtar veror PISU, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit në përgjithësi, në veçanti Programi me i ri i akredituar Master në FIN – Menaxhimi I Integruar I Resurseve Ujore si dhe gjendja e menaxhimit të resurseve ujore dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Kosovë.

Ndër temat e diskutimit do të jetë edhe Konferenca “4th Conference of Ecological and Environmental Engineering” që do të mbahet më 14-17 May 2024 në Beja, Portugali, pjesë e organizimit të së cilës do të jetë edhe Universiteti i Prishtinës.

Të planifikuara janë edhe vizitat e punëtorisë teknike BOKU-SIG dhe laboratorit kimik, laboratorit të inxhinierisë hidraulike BOKU-IWA, ekskursioni një ditë i një kënete të konstruktuar të trajtimit me rrjedhje vertikale në dy faza (2VSSF) dhe një impiant të trajtimit të ujërave të ndotura.





